




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

## Drejtoria e Administratës

*Spektori për Integritime Evropiane  
Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore*

### *Ftesë Publike për Financimin për OJQ-të për Vitin 2024*

Drejtoria e Administratës, sektori për integritime evropiane, drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, shpallë thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në promovimin e të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore në kuadër të planit të veprimit.

Aktivitete promovuese për të drejtat në punë dhe pushimi i lehonisë  
Promovimi i grave të suksesshme në profesione jotipike si bujqësi, ndërmarrësi etj  
Informimi i grave për mundësitë e përfitimit nga programet komunale  
Organizimi i punëtorive një ditore me grate e interesuara për të filluar biznese

Avancimi i barazise gjinore dhe zhdukja e pabarazive dhe stereotipeve gjinore  
Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtat e tyre në qasjen në shërbime  
Organizimi i takimeve vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi, pronë, dhe regjistrimi i pronave në emer të dy bashkëshortëve  
Organizimi i takimeve me gra dhe vajza për informimin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në dëgjime buxhetore

Avancimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrjeParandalim dhe Vetëdijësim kundër dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore  
Fushatë informuese lokale në kuadër të fushatës ndërkombëtare të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje  
Organizimi dhe shfaqja e performancës në rrugë (me shkollat) me tematikë kundër Dhunës në Familje.

Të Drejtave të Njeriut, të drejtat e Fëmijëve, të drejtat e Personave me Afësi të Kufizuar, dhe të drejtat e Komuniteteve

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë:  
Organizatat te cilat:

Kanë përvojë të dëshmuar në zbatimin e projekteve nga fusha të cilën e mbulojnë (të bashkëngjiten dëshmitë për projektet e zbatuara në projekt-propozim;  
Bëjnë përfshirjen e profesionistëve nga fusha e ngritjes së kapaciteteve për të zbatuar pjesët profesionale;  
Kanë qenë korrekte në zbatimin dhe raportimin e projekteve të financuara nga Drejtoria e Administratës

## **VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES**

Vlera totale e planifikuar e ftesës është **10,000.00 Euro**

Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të që mund të alokohet për çdo projekt është **500.00Euro**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **2,000.00 Euro**.

Projektet mund të financohen në shumën [e 100% ] të totalit të kostove të pranueshme të projektit. Aplikantët dhe partnerët potencialë nuk është nevojshme të sigurojnë bashkëfinancim nga burimet tjera (*publike ose private*) të financimit

## **KUSHTET FORMALE TË THIRRJES**

### **Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?**

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike, organizatat të cilat janë me seli në Skenderaj. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e rinisë përkatësish të komponentës së pjesëmarrjes. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj *Drejtorisë së Administratës* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje, dhe vetëm një (1) projekt} për secilën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit është për 2-4 muaj. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.

### **Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit**

Partneriteti me organizata të tjera është i preferueshëm dhe nuk është i detyrueshëm, gjithashtu e njëjta organizatë mund të marr pjesë në më shumë së një projekt.

Partneriteti përfshinë marrëdhëniet mes OJQ-ve që nënkupton përgjegjësi në zbatimin e programit/projektit të financuar nga ofruesit e mbështetjes financiare. Në mënyrë që projekti/programi të zbatohet pa probleme, të gjitha organizatat që janë pjesë e partneritetit duhet të pajtohen me parimet e praktikës së mirë në partneritet:

### **Kushtet e Partneritetit**

Para dorëzimit të aplikimit tek ofruesi i mbështetjes financiare, të gjithë partnerët do të lexojnë tekstin e thirrjes publike dhe udhëzimet për dorëzimin e aplikacioneve dhe të kuptojnë rolin e tyre në projekt/program.

Të gjithë partnerët autorizojë Aplikuesin për t'i përfaqësuar ata në të gjitha marrëdhëniet me ofruesin e mbështetjes financiare në kontekstin e zbatimit të projektit/programit.

Aplikuesi dhe të gjitha organizatat partnere do të takohen rregullisht dhe të punojnë së bashku për zbatimin e projektit/programit, vlerësimin dhe shqyrtimin e mënyrave për tejkalimin e sfidave dhe vështirësive në zbatimin e projektit.

Të gjithë partnerët do të marrin pjesë në përgatitjen e pasqyrave të përbashkëta përshkruese dhe të veçanta financiare, dhe aplikuesi në emër të të gjithë partnerëve paraqet ato tek ofruesi i mbështetjes financiare.

Propozimi për ndryshime në partnerët e projektit duhet të bëhet me marrëveshje në mes të partnerëve, ndërsa aplikuesi e dorëzon atë tek ofruesi i mbështetjes financiare

### **Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

Periudha e zbatimit të projektit është më së largu 6 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës.

#### **Vendi për zbatimin e projektit është: Komuna e Skenderajt**

Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:

Nxitjen e autoriteteve lokale, institucionet publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile në promovimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes te grave  
Avancimin dhe promovimin e politikave qeveritare në fushën e fuqizimit barazisë gjinore;  
Mentorimin dhe trajnimin e organizatave lokale që veprojnë në fushën e barazisë gjinore te drejtave të njeriut;  
Adresimin e problemeve specifike të të drejtave të rinjve që ndikojnë drejt për së drejti në nxitjen e pjesëmarrjes grave në politik bërje dhe vendimmarrje;

Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

Nuk financohen aktivitetet që zgjasin më pak se një muaj dhe më shumë se kater muaj, pajisjet sportive, inventari, qiraja për zyre, komunalit si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që tek të rinjtë mund të kenë ndikim politik, religjioz etj.

### **Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes**

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

#### **Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme**

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkt përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

## **Kostot direkte (specifiko shpenzimet që janë të lidhura direkt me projektin)**

### **Burimet Njerëzore**

#### **PAGAT (specifiko kosto e pagave dhe përfitimeve për punonjësit)**

##### **. Kontratat e shërbimeve**

##### **Kontrata e Shërbimit me aktivitete Kontraktor nr. 1**

##### **Kontrata e Shërbimit me aktivitete Kontraktor nr. 2**

2. Udhëtimi (specifiko koston, për shembull, të transportit publik, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e akomodimit, medijet për qëllimin e kryerjes së aktiviteteve të projektit)

### **Mallrat**

4. Kostot e tjera, shërbimet (fushata, trajnimi për përdoruesit kryesorë, kostoja e monitorimit të implementimit të projektit, kostot e tjera që janë të nevojshme dhe të lidhura direkt dhe të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të projektit dhe të ngjashme.)

B) Shpenzimet indirekte (janë kostot që janë të lidhura në mënyrë indirekte me zbatimin e projektit, përqindja e deri në [një limit përqindje për këtë linjë buxhetore nëse ka] nga vlera e buxhetit të projektit kërkuar nga [ofruesi mbështetjes financiare])

5. Shpenzimet e kryerjes së operacioneve (specifiko, për shembull, shërbimet, hapësirë me qira, shërbimit të kontabilitetit etj.)

### **Shpenzimet e tërthorta të pranueshme**

Përveç shpenzime të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit). Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

### **Shpenzimet e papranueshme**

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë: aktivitetet që zgjasin më pak se një muaj dhe më shumë se tre muaj, pajisjet sportive, inventari, qiraja për zyre, komunalit si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që tek të rinjtë mund të kenë ndikim politik, religjioz etj.

#### **1. SI TË APLIKONI?**

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, formularët janë në dispozicion në faqen e komunës(linkun)Kat (<https://kk.rks-gov.net/Skenderaj>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht në zarf të mbyllura, në adresën e mëposhtme:

**Komuna e Skenderajt**

**Kati përdhese, zyra, nr13**

**Rruga, 28 Nëntori, 41000 Skenderaj**

**Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune.**

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (e shtypur ne dy kopje)
2. Formulari i Propozim buxhetit (e shtypur ne dy kopje)
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (e shtypur ne dy kopje)
4. F12 Formular i deklaratës se partneritetit.doc (e shtypur nëse aplikohet)
5. F13 Forma e deklaratës se projekteve te financuara. docx(e shtypur ne dy kopje)
6. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit, dhe certifikata e nr fiskal si dhe dëshmia mbi llogarinë bankare(e shtypur ne dy kopje)

### **Forma përshkruese projekt propozimit**

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë. Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

### **Përmbajtja e formës Buxhetit**

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

### **Ku ta dorëzoni aplikimin?**

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur në dy kopje. Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni i shtypur në dy kopje duhet të vendosen në një zarf të mbyllur. Aplikimi origjinal duhet të dërgohet me postë ose në person (dhe të dorëzohet në Zyrën përkatëse). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin ***"Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues"***

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

**Komuna e Skenderajt**  
**Zyra, nr13**  
**Rruga, 28 Nëntori, 41000 Skenderaj**

### **Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve**

Afati për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë** pune nga dita e thirrjes, përkatësisht **08.04.2024** deri më **30.04.2024 ora 16.00**. Kërkesa është dorëzuar brenda periudhës së thirrjes nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në Zyrë, aplikanti do të lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

*Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.*

### **Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?**

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresat e mëposhtme: [besnik.zabelaj@rks-gov.net](mailto:besnik.zabelaj@rks-gov.net), [qefshere.dautaj@rks-gov.net](mailto:qefshere.dautaj@rks-gov.net) [mirsad.gashi@rks-gov.net](mailto:mirsad.gashi@rks-gov.net) jo më vonë se 5 ditë para skadimit të thirrjes.



[F9-Formulari-i projekt programit.docx](#)

[F10-formulari i propozim -buxhetit.xlsx](#)

[F11 Forma e deklarates per financimin e dyfishte-skenderaj.doc](#)

[F12 Formular i deklarates se partneritetit.doc](#)

[F13 Forma e deklarates se projekteve te financuara....doc](#)